


gorenje

SQ

AL

**UDHËZIMET PËR
PËRDORIMIN
E NJË FURRE INKASO**



Ju falenderojmë për besimin tuaj dhe për blerjen e pajisjes sonë elektroshtëpiake.

Ky manual udhëzimi i detajuar është dhënë për ta bërë më të lehtë përdorimin e këtij produkti. Udhëzimet duhet t'ju lejojnë që të mësoni për pajisjen tuaj të re elektroshtëpiake sa më shpejt që të jetë e mundur.

Sigurohuni që keni marrë një pajisje elektroshtëpiake të padëmtuar. Në qoftë se gjeni démtime nga transporti, ju lutemi të kontaktoni me shitësin nga ku e keni blerë pajisjen ose me magazinën rajonale nga ku është furnizuar ajo. Numri i telefonit mund të gjendet në faturë ose në dëftesën e dorëzimit.

Udhëzimet për instalimin dhe lidhjen jepen në një fletë të veçantë.

Udhëzimet për përdorimin, instalimin dhe lidhjen gjenden edhe në faqen tonë të internetit:

<http://www.gorenje.com>

Simbolet e mëposhtme përdoren gjatë gjithë manualit dhe kanë kuptimet si vijon:

 **INFORMACION!**
Informacion, këshillë ose rekandim

 **PARALAJMËRIM!**
Kujdes – rrezik i përgjithshëm



Është e rëndësishme që të lexoni me kujdes udhëzimet.

Përbajtja

Masa paraprake për sigurinë	4
Përdorimi i sigurt dhe korrekt i furrës gjatë pastrimit pirolistik	6
Paralajmërimë të tjera të rëndësishme për sigurinë	6
Përshkrimi i pajisjes	9
Plaka e të dhënavë teknike - informacioni i produktit	9
Njësia e kontrollit	10
Elementet e pajisjes	11
Drita e kontrollit	11
Udhëzuesit	11
Çelësi i derës së furrës	12
Ventilatori i freskimit	12
Pajiset dhe aksesorët e furrës	12
Përpara përdorimit të parë	14
Ndezja për herë të parë	15
Testimi i fortësisë së ujit	15
Përgjedhja e parametrave	16
Modaliteti profesional (pro bake)	16
MODALITETI AUTOMATIK (auto bake)	25
ZGJEDHJA E FUNKSIONEVE SHTESË (extra bake)	28
Bllokimi i tasteve	28
Fillimi i procesit të gatimit	30
Fundi i gatimit dhe fikja e furrës	30
Zgjedhja e cilësimeve të përgjithshme	31
Këshilla dhe sugjerime të përgjithshme për pjekjen	34
Tabela e gatimit	35
Gatimi me një sondë temperature	39
Nivelet e rekomanduara të gatimit për lloje të ndryshme të mishit	41
Mirëmbajtja dhe pastrimi	42
Pastrimi automatik i furrës - piroliza	43
Pastrimi i tabakasë së avullimit	45
Pastrimi i sistemit të avullit	46
Heqja e udhëzuesve të telit dhe udhëzuesve të fiksuar (të zgjatshëm) për nxjerrje	46
Heqja dhe zëvendësimi i derës së furrës dhe xhamave	47
Zëvendësimi i llampës	48
Tabela e zgjidhjes së problemeve dhe gabimeve	49
Kujdesi i veçantë dhe raportimi i defekteve	49
Hedhja	50
Testi i gatimit	51

Masa paraprake për sigurinë

MASAT E RËNDËSISHME TË SIGURISË – LEXONI ME KUJDES UDHËZIMET DHE RUAJINI PËR REFERENCË NË TË ARDHMEN.

Pajisja elektroshtëpiake duhet të lidhet me linjat fikse të telave, të cilat kanë të inkorporuara mënyrat e shkëputjes. Linjat fikse të telave duhet të jenë në përputhje me rregullat për instalimet elektrike.

Mjetet për të shkëputur lidhjen duhet të përfshihen në kabllin e fiksuar në përputhje me rregullat për kabllot.

Pajisja elektroshtëpiake nuk duhet të instalohet mbrapa asnje dere dekorative, në mënyrë që të shmanget mbinxehja.

Nëse rrjeti i furnizimit është dëmtuar, ai duhet të zëvendësohet nga prodhuesi, agjenti i tij i shërbimeve ose persona të kualifikuar në mënyrë të ngashme për të shmangur një rrezik (vetëm për pajisje të furnizuara me kabell lidhës).

Kjo pajisje elektroshtëpiake mund të përdoret nga fëmijët 8 vjeç e lart dhe nga personat me aftësi të reduktuara fizike, ndijore apo mendore ose nga persona që nuk kanë eksperiencë dhe njohuri, në rast se atyre u janë dhënë udhëzime dhe i kanë mbikëqyrur për përdorimin e pajisjes elektroshtëpiake në mënyrë të sigurt, si dhe në rast se ata i kuptojnë rreziqet e mundshme. Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen elektroshtëpiake. Pastrimi dhe mirëmbajtja nuk duhet të realizohet nga fëmijët pa mbikëqyrje.

PARALAJMËRIM: Pjesët e aksesueshme mund të nxehen gjatë përdorimit. Fëmijët e vegjël duhen mbajtur larg.

KUJDES: Pajisja dhe disa nga pjesët e saj të prekshme mund të nxehen shumë gjatë përdorimit. Tregoni kujdes dhe shmangni prekjen e elementeve nxehës. Mbani larg fëmijët nën moshën 8 vjeç nëse nuk janë nën mbikëqyrje të vazhdueshme.

Pajisja elektroshtëpiake nuk është synuar që të kontrollohet nga kohëmatësa të jashtëm apo sistem i veçantë i kontrollit në distancë.

Përdorni vetëm sondën e temperaturës që rekomandohet përkëtë furre.

Mos përdorni pastrues të ashpër gërryes ose kruajtëse të mprehta prej metali për të pastruar xhamin e derës së furrës apo xhamin e kapakëve me mentesha të pllakës së gatimit (sipas rastit), pasi ato mund të gërvishatin sipërfaqen, gjë që mund të rezultojë në thyerjen e xhamit.

Mos përdorni pastrues me avull ose pastrues me presion të lartë për të pastruar pajisjen, pasi kjo mund të rezultojë në goditje elektrike.

PARALAJMËRIM: Përpara zëvendësimit të poçit të dritës, sigurojuni që pajisja elektroshtëpiake është shkëputur nga rrjeti i furnizimit, në mënyrë që të parandalohet rreziku i goditjes elektrike.

Asnjëherë mos derdhni ujë direkt në pjesën e poshtme të zgavrës së furrës. Dallimet në temperaturë mund të rezultojnë në dëmtim të veshjes së smaltit.

Përdorimi i sigurt dhe korrekt i furrës gjatë pastrimit pirolitik

Para pastrimit pirolitik, pajisja duhet të përgatitet në mënyrë të përshtatshme (shih kapitullin "Pastrimi automatik i furrës - piroliza").

Përpara se të filloni procesin e pastrimit, hiqni çdo mbetje të lëngut të derdhur dhe të gjitha pjesët e lëvizshme nga zgavra e furrës.

Gjatë procesit të pastrimit automatik, furra nxehet në një temperaturë shumë të lartë dhe është shumë e nxeh të edhe nga jashtë. Rrezik djegieje! Mbani fëmijët larg furrës.

Paralajmërime të tjera të rëndësishme për sigurinë

Pajisja elektroshtëpiake është e synuar vetëm për përdorim shtëpiak. Mos e përdorni për asnjë qëllim tjetër, si për ngrohje të dhomës, tharje të kafshëve të vogla shtëpiake ose kafshëve të tjera, letrës, stofrave tekstile, bimëve etj., pasi kjo mund të shkaktojë plagosje ose rrezik zjarri.

Pajisja elektroshtëpiake duhet të lidhet me linjat fikse të telave, të cilat kanë të inkorporuara mënyrat e shkëputjes. Linjat fikse të telave duhet të janë në përputhje me rregullat për instalimet elektrike.

Ne rekomandojmë që (për shkak të peshës së pajisjes) të paktën dy persona të mbajnë dhe instalojnë pajisjen.

Mos e ngrini pajisjen duke e kapur nga doreza e derës.

Menteshat e derës së furrës mund të dëmtohen nga ngarkesa e tepërt. Mos qëndroni apo rrini ulur në derën e hapur të furrës dhe mos u mbështesni pas saj. Gjithashtu, mos vendosni objekte të rënda mbi derën e furrës.

Nëse kabllot e rrymës së pajisjeve të tjera të vendosura pranë kësaj pajisjeje ngatërrohen në derën e furrës, ato mund të dëmtohen, gjë që nga ana tjetër mund të rezultojë në një qark të shkurtër. Prandaj, sigurohuni që kabllot e rrymës së pajisjeve të tjera të janë gjithmonë në një distancë të sigurt.

Sigurojuni që tubat nuk janë asnjëherë të mbuluar ose të penguar në asnjë formë tjetër.

Mos vendosni letër alumini në zgavrën e furrës dhe asnjë tavë pjekjeje ose enë tjetër gatimi në pjesën e poshtme të furrës. Kjo do të pengonte dhe zvogëlonë qarkullimin e ajrit në furrë, duke ngadalësuar procesin e pjekjes dhe duke shkatërruar shtresën e smaltit.

Ne ju rekomandojmë të shmangni hapjen e derës së furrës gjatë pjekjes, pasi kjo rrit konsumin e energjisë dhe akumulimin e kondensatit.

Në fund të procesit të pjekjes dhe gjatë pjekjes, bëni kujdes kur hapni derën e furrës, pasi ekziston rreziku i djegies.

Për të parandaluar grumbullimin e gjelqerës, lini hapur derën e furrës pas pjekjes ose gjatë përdorimit të furrës për të lejuar që zgavra e furrës të ftohen në temperaturën e dhomës.

Pastroni furrën pasi tē jetë ftohur plotësisht.

Mospërputhjet e mundshme në nuancat e ngjyrave ndërmjet pajisjeve elektroshëpiake ose përbërësve të ndryshëm brenda të njëjtës linjë modeli mund tē ndodhin për shkak të faktorëve të ndryshëm, siç janë këndet e ndryshme nga ku shikohet pajisja elektroshëpiake, mjediset me ngjyra të ndryshme, materialet dhe ndricimi i dhomës.

Mos e përdorni pajisjen nëse është e dëmtuar. Shkëputeni pajisjen nga rrjeti elektrik dhe telefononi një qendër të autorizuar shërbimi.

Furra mund tē përdoret në mënyrë të sigurt me ose pa udhëzues të enës së pjekjes.

Mos i ruani sendet në furre, gjë që mund tē shkaktojë rrezik kur furra është e ndezur.

Devijimi i shfaqjes së kohës ditore në ekran nuk ndikon në funksionalitetin e pajisjes dhe mund tē ndodhë për shkak të luhatjeve në frekuencën e rrjetit elektrik.

Përparrë se tē aktivizoni pastrimin automatik, lexoni dhe ndiqni me kujdes tē gjitha udhëzimet në kapitullin Pastrimi dhe mirëmbajtja, i cili pëershkruan përdorimin korrekt dhe tē sigurt tē këtij funksioni

Mos vendosni asgjë në pjesën e poshtme të furrës gjatë procesit të pastrimit automatik.

Pastrimi pirolitik përfshin temperaturat shumë tē larta që mund tē shkaktojnë lëshimin e tymit dhe avujve nga mbetjet e ushqimit. Ne ju rekomandojmë që tē siguronit ventilim tē plotë tē kuzhinës gjatë procesit të pastrimit pirolitik. Kafshët e vogla ose ato shtëpiake janë shumë tē ndjeshme ndaj çdo tymi që lëshohet gjatë pastrimit pirolitik të furrave. Ne rekomandojmë largimin e tyre nga kuzhina gjatë pastrimit pirolitik dhe ajrosjen e kuzhinës plotësisht pas procesit të pastrimit.

Mos e hapni derën e furrës gjatë pastrimit.

Sigurohuni që asnjë objekt i huaj tē mos hyjë në hapjen për kyçjen e udhëzuesit tē derës, pasi kjo mund tē bllokojë kyçjen automatiqe tē derës gjatë procesit të pastrimit të furrës.

Mos prekni asnjë sipërfaqe metalike ose pjesë tē pajisjes gjatë procesit të pastrimit automatik!

Në rast tē ndërprerjes së energjisë gjatë procesit të pastrimit automatik, programi do tē ndërpritet pas dy minutash dhe dera e furrës do tē mbetet e kyçur. Dera do tē shkyçet kur pajisja tē ndiejë që temperatura ka rënë nën 150 °C në qendër tē zgavrës së furrës.

Pas procesit të vetë-pastrimit, zgavra e furrës dhe aksesorët e furrës mund tē ndryshojnë ngjyrën dhe tē humbin shkëlqimin e tyre. Kjo nuk ndikon në funksionalitetin e tyre.

Vëmendje - sipërfaqe e nxeh të gjatë pastrimit pirolitik



Përparrë se tē lidhni pajisjen me rrjetin elektrik, lëreni atë në temperaturën e dhomës për pak kohë për tē lejuar që tē gjithë përbërësit tē përshtaten me temperaturën e dhomës. Nëse furra është ruanjtur në një temperaturë afér pikës së ngirjës ose poshtë saj, kjo mund tē jetë e rrezikshme për disa përbërës, veçanërisht për pompën.

Mos e përdorni pajisjen në një ambient më tē ftohtë se 5 °C. Nëse pajisja ndizet në kushte tē tillë, pompa mund tē dëmtohet.

Mos përdorni ujë tē distiluar, ujë rubineti me përbajtje tē lartë klori apo lëngje tē tjera tē ngjashme.

Kur piqni me injeksion me avull, hapni gjithmonë derën e furrës plotësisht kur të përfundojë procesi i pjetjes. Nëse nuk veproni kështu, avulli që ngrihet nga zgavra e furrës mund të ndikojë në funksionimin e njësisë së kontrollit.

Vendosni enën e avullimit në pajisje vetëm kur piqni me injeksion me avull. Kur nuk përdorni funksionin e injeksionit me avull, hiqeni atë.

Hiqni dhe zëvendësoni tabakanë e avullimit vetëm kur furra të jetë ftohur plotësisht.

PARALAJMËRIM!

Lexoni me kujdes udhëzimet e përdorimit përpara se të lidhni pajisjen elektroshtëpiake.
Riparimi ose çdo pretendim për garanci që rezulton nga lidhja ose përdorimi i parregullt i pajisjes nuk do të mbulohet nga garancia.


Përshkrimi i pajisjes



INFORMACION!

Funksionet dhe elementet e pajisjes varen nga modeli.


Elementet themelore të pajisjes suaj përfshijnë udhëzuesin e telave, një tabaka të cekët për pjekje dhe një skarë.



1. Njësia e kontrollit
2. Çelësi i cisternës së ujit
3. Çelësi i derës
4. Ndriçimi
5. Tabakaja e avullimit
6. Foleja e sondës së temperaturës
7. Udhëzuesit – nivelet e gatimit
8. Pllaka e të dhënave teknike
9. Dera e furrës
10. Doreza e derës

Pllaka e të dhënave teknike - informacioni i produktit


Pllaka e të dhënave teknike me informacionin bazë për pajisjen eshtë e bashkangjitur në buzë të furrës.



1. Numri serik
2. Modeli
3. Lloji
4. Marka
5. Kodi/ID
6. Kodi QR (në varësi të modelit)
7. Informacione teknike
8. Treguesit ose simbolet e pajtueshmërisë

Njësia e kontrollit

(në varësi të modelit)



1. on | off butoni
2. (pro bake) butoni i modalitetit profesional
3. (auto bake) butoni i modalitetit automatik
4. Zgjedha e cilësimeve dhe çelësi i konfirmimit
 - rrotulloni çelësin për të zgjedhur një cilësim
 - shtypni çelësin për të konfirmuar cilësimin
5. (extra bake) buto pér funksionet shtesë dhe cilësimet e përgjithshme të pajisjes
6. (light) butoni pér ndezjen dhe fikjen e ndriçimit të furrës
7. Butoni start/stop pér fillimin ose ndaljen dhe konfirmimin e cilësimeve
8. Ekran:
 - sistemet e pjkjes, modaliteti me hapa (STEP)
 - sisteme të veçanta të pjkjes, programe automatike, gratina
 - ora, funksionet e kohëmatësit, sonda e temperaturës, koha e pjkjes
 - programe speciale, ngrohja paraprake
 - temperatura, pesha

— Pjesa e ndriçuar e vijës - tregon fushën e zgjedhur aktualisht, nga A deri në E.

▼ Shigjeta - shfaq cilësimin bazë të zgjedhura (pro bake), (auto bake), (extra bake).

INFORMACION!

Për përgjigje më të mirë të butonit, prekni butonat me një zonë të madhe të majës së gishtit. Sa herë që shtypni një buton, kjo do të pranohet nga një sinjal i shkurtër akustik (nëse funksioni është i disponueshëm).

Elementet e pajisjes


Drita e kontrollit

Drita e furrës: drita e furrës ndizet kur hapni ose mbyllni derën e furrës, kur ndizni furrën, në fund të procesit të pjekjes dhe kur prekni butonin e dritës së furrës në njësinë e kontrollit.

Udhëzuesit


- Udhëzuesit lejojnë gatimin ose pjekjen në 5 nivele raftesh.
- Nivelet e lartësisë së udhëzuesve në të cilët mund të futen raftet duhet të llogariten nga poshtë lart.
- Nivelet udhëzuese 4 dhe 5 janë për tiganisje/pjekje.
- Kur fusni elementet, duhet t'i rrotulloni në mënyrë të saktë.

Udhëzuesit me tela



Në rast të udhëzuesve të telit, fusni gjithmonë raftin e telit (skarë) dhe tabakatë për pjekje në vendin midis pjesës së sipërme dhe të poshtme të secilit nivel udhëzues.


Udhëzuesit e fiksuar për nxjerrje (në varësi të modelit)



Udhëzuesit për nxjerrje mund të vendosen për nivelin e 2-të dhe të 4-t.

Në rast të udhëzuesve të fiksuar për nxjerrje, vendosni raftin ose tabakanë për pjekje mbi udhëzues. Mund ta vendosni raftin e telit direkt në një tabaka pjekjeje (tabaka të cekët ose të thellë pjekjeje për të gjitha qëllimet) dhe t'i vendosni të dyja në të njëtin udhëzues; në këtë rast, tabakaja për pjekje vepron si një tabaka pikimi.

Udhëzuesit për nxjerrje me kërcitje (në varësi të modelit)



Udhëzuesit për nxjerrje me kërcitje mund të futen në çdo hapësirë midis dy niveleve të udhëzuesit të telit.

Vendosni udhëzuesit simetrikisht mbi udhëzuesit e telit në anën e majtë dhe të djathtë të zgavrës së furrës. Së pari, lidhni kapësen e sipërme të udhëzuesit nën telin e udhëzuesit të telit. Pastaj, shtypni kapësen e poshtme në pozicionin e duhur derisa të dëgjoni një kërcitje.

SHËNIM: Udhëzuesit mund të bashkëngjiten në çdo lartësi midis dy niveleve të udhëzuesve të telit.

- INFORMACION!

Udhëzuesit për nxjerrje me kërcitje nuk mund të montohen në udhëzues me zgjatje të pjesshme fiksë në dy nivele. Sidoqoftë, ata mund të montohen në udhëzues pjesërisht të zgjatshëm në një nivel të vetëm, në nivelet 3-4 dhe 4-5.

Sigurohuni që udhëzuesi për nxjerrje të jetë rrotulluar si duhet dhe të shtrihet përjashta, pra jashtë furrës.

Çelësi i derës së furrës

(në varësi të modelit)

Nëse dera e furrës hapet gjatë përdorimit të furrës, çelësi çaktivizon ngrohësin dhe ventilatorin në zgavrën e furrës. Kur dera është e mbyllur, çelësi aktivizon përsëri pajisjen.

PARALAJMËRIM!

Nuk lejohet përdorimi i furrës me derë të hapur dhe çelësin e derës të kapur (të mbyllur). Furra do të sinjalizojë një gabim dhe do të duhet të rivendosen parametrat fillestare.

Ventilatori i freskimit


Pajisja përmban një ventilator ftohës që ftoh karkasën, derën dhe njësinë e kontrollit të pajisjes. Pasi të filket furra, ventilatori ftohës vazhdon të funksionojë për një kohë të shkurtër në mënyrë që të ftohet furra.

Pajisjet dhe aksesorët e furrës

(në varësi të modelit)

PARALAJMËRIM!

Hiqni të gjitha pajisjet nga furra, duke përfshirë udhëzuesit e rafteve. Pastrimi i pajisjeve (tepsitë e thella ose të cekëta të pjakjes për të gjitha qëllimet) me pirolizë është i mundur vetëm nëse furra është e pajisur me udhëzues shtesë me tela (shih kapitullin "Pastrimi i pajisjeve të furnizuara me pirolizë").



RAFTI I TELIT përdoret për tiganisje apo pjekje ose si mbështetje për një tigan, tepsi ose pjatë pjekjeje me ushqimin që po piqni.

INFORMACION!


Ekiston një shul sigurie në skarë. Prandaj, skara duhet të ngrihet pak në pjesën e përparme kur nxirret nga furra.



TABAKAJA E CEKËT PËR PJEKJE përdoret për ëmbëlsira të sheshta dhe të vogla. Mund të përdoret gjithashtu si një tabaka pikimi.

PARALAJMËRIM!

Tabakaja e cekët për pjekje mund të deformohet ndërsa nxehet në furrë. Pasi të ftohet, ajo kthehet në formën fillestare. Një deformim i tillë nuk ndikon në funksionimin e saj.



TEPSIA E CEKËT ME VRIMA PËR PJEKJE përdoret për gatim me sisteme që përbajnë injekzion me avull dhe për skuje me ajër. Vrimat përmirësojnë qarkullimin e ajrit rrëth ushqimit për një sipërfaqe më krokante. Kur gatuani ushqim me përbajtje të lartë lëngu (ujë, yndyrë), vendosni tepsinë e cekët për pjekje ose tepsinë e thelli për të gjitha qëllimet një raft më poshtë për të shërbyer si tabaka kullimi.



TEPSIA E THELLË SHUMËFUNKSIONALE PËR PJEKJE përdoret për pjekjen e perimeve dhe ëmbëlsirave të njoma. Mund të përdoret gjithashtu si një tabaka pikimi.

INFORMACION!

Asnjëherë mos fusni tepsinë e thelli për të gjitha qëllimet (ose universale) në udhëzuesin e parë gjatë pjekjes.



SONDA e temperaturës (BAKESENSOR).



PARALAJMËRIM!

Pajisja elektroshtëpiake dhe disa nga pjesët e saj të prekshme kanë prirjen të nxehen gjatë gatimit.

Përpara përdorimit të parë

- Hiqni pajisjet shtesë të furrës dhe çdo paketim (karton, shkumë polistireni) nga furra.
- Fshini pajisjet shtesë dhe pjesët e brendshme të furrës me një leckë të lagur. Mos përdorni lecka ose pastrues të ashpër.
- Ngroheni një furre të zbrazët për rreth një orë me sistemin e ngrohësit të sipërm dhe të poshtëm në një temperaturë prej 250°C . Do të ndihet aroma karakteristike e "një furre të re", prandaj ajrosni plotësisht dhomën gjatë këtij procesi.

Ndezja për herë të parë

Pasi ta lidhni pajisjen tuaj elektroshtëpiake ose pas një ndërprerjeje të zgjatur të energjisë, në ekran do të ndriçojë 12:00.

Së pari, zgjidhni dhe konfirmoni cilësimet themelore në vijim.

- INFORMACION!

Ndryshoni ato duke rrotulluar ÇELËSIN. Për të konfirmuar cilësimin e dëshiruar, shtypni ÇELËSIN ose prekni butonin **start | stop**.



12:00

1. CAKTIMI I ORËS

Caktoni orën/kohën e ditës. Së pari, caktoni dhe konfirmoni minutat; pastaj caktoni dhe konfirmoni orët.

- INFORMACION!

Për të caktuar ose rregulluar orën më vonë, shihni kapitullin Funksionet shtesë.



2. VOLUMI I SINJALIT AKUSTIK

Volumi mesatar është cilësimi i paracaktuar. Shenja **VoL** dhe vlera e vendosur aktualisht për volumin e sinjalit akustik do të shfaqet në njësinë e ekranit. Rrotulloni ÇELËSIN për të rritur ose ulur volumin e butonit.



3. ERRËSUESI I EKRANIT

Intensiteti mesatar i dritës është cilësimi i paracaktuar. Shenja **br ht** dhe vlera e vendosur aktualisht për intensitetin e dritës së ekranit do të shfaqet në njësinë e ekranit. Rrotulloni ÇELËSIN për të rritur ose ulur intensitetin e ndriçimit.

Pasi të konfirmoni cilësimet e përgjedhura, ora do të shfaqet në ekran. Pajisja është në gjendjen gati përdorim.

Testimi i fortësisë së ujit

Pastrimi varet nga sa shpesh e përdorni funksionin e injektimit me avull dhe nga fortësia e ujit të përdorur.

Zhysni shiritin e letrës testuese (të dhënë me pajisjen) në ujë për një (1) sekondë. Prisni një minutë, pastaj vini re numrin e vijave në shiritin e letrës. Cilësimi i nivelit duhet të përkijnë me numrin e vijave me ngjyrë në shiritin e letrës (shih kapitullin "Cilësimet e përgjithshme").

4 shirita të gjelbër - Hrd 1	1 shirit i kuq - Hrd 2	2 shirita të kuq - Hrd 3
3 shirita të kuq - Hrd 4	4 shirita të kuq - Hrd 5	

Përzgjedhja e parametrave

Ndërsa qaja lejon zgjedjen e disa modalitetave të funksionimit:

- Modaliteti profesional (pro bake)
- Modaliteti automatik (auto bake)
- Funksione shtesë (extra bake)
- Programi i hapave (STEP) në modalitetin profesional (pro bake)
- Programet automatike në modalitetin automatik (auto bake)

INFORMACION!


- Rrotulloni ÇELËSIN për të lëvizur nëpër cilësimet.
- Së pari, konfirmoni cilësimin e zgjedhur duke shtypur KNOB; pastaj, ndryshoni cilësimin.
- Konfirmoni çdo cilësim duke shtypur KNOB.
- Një vijë dhe një shigjetë tregojnë vendndodhjen e parametrit që kërkoni të vendosni.
- Shtypni çelësin **start | stop** për të filluar programin.
- Përdorimi i çelësit **on | off**:
 - prekje e shkurtër: ndizni ose fikni furrën, ndalon procesin ose funksionin e pjekjes.
 - prekje e gjatë: furra kalon në modalitetin e konsumit të ulët të energjisë (kursim i energjisë).Asnjë çelës ose BUTON nuk është aktiv, përvèç butonit **on | off**. Për të ndezur furrën, mban shtypur gjatë këtë buton.



pro bake Modaliteti profesional (pro bake)

Ky funksion lejon vendosjen e parametrave të pjekjes - sistemin e pjekjes, temperaturën, ngrohjen paraprake të shpejtë dhe kohën e pjekjes - lirisht, sipas gjykimit të përdoruesit.

Prekni butonin **pro bake** dhe vendosni sa vijon:



Një sistem pjekjeje

C kohëzgjatja e programit

D preheating

E temperatura

Për më tepër, mund të vendosen sa vijon:

- funksionet e kohëmatësit (shih kapitullin Funksionet e kohëmatësit)
- mënyra e pjekjes me hapa (STEP) (shih kapitullin Programi Step)
- gratin (GRATIN) (shih kapitullin Fillimi i procesit të gatimit)

Paranxejja e shpejtë

Përdorni funksionin e nxehjes paraprake nëse dëshironi të ngrohni furrën në temperaturën e dëshiruar sa më shpejt të jetë e mundur.

Për të aktivizuar nxehjen e shpejtë paraprake, rrotulloni KNOB në cilësimin **» PREHEAT III** (shiko figurën, emërtimin D). Konfirmoni përzgjedhjen. Rrotulloni KNOB për të zgjedhur shenjën e ndezur plotësisht dhe konfirmojeni atë. Funksioni tanë është i aktivizuar.

Kur të arrihet temperatura e zgjedhur, procesi i para -ngrohjes ndalet dhe lëshohet një sinjal akustik. **door** do të shfaqet në ekran. Hapeni derën dhe fusni ushqimin. Programi do të vazhdojë automatikisht pjkjen me cilësimet e zgjedhura.

INFORMACION!

Kur aktivizohet funksioni i nxehjes së shpejtë paraprake, funksioni i fillimit të vonuar nuk mund të përdoret.

Për sistemet me injeksion me avull, nxehja paraprake nuk mund të vendoset.

ZGJEDHJA E SISTEMIT TË GATIMIT

Simboli	Përdorimi
	AJËR I NXEHTË Ajri i nxehtë bën të mundur qarkullim më të mirë të ajrit të nxehtë anembanë ushqimit. Në këtë mënyrë, sipërfaqja thahet dhe krijohet një kore më e trashë. Përdoren i këtë sistem për të pjekur mishin, brumërat dhe perimet, si edhe për ta tharë ushqimin në një skarë të vetme ose në disa skara njëkohësisht.
	SISTEMI PIZZA Ky sistem është optimal për pjkjen e picave dhe pasticervje me përbajtje më të lartë të ujit. Përdoren atë për të pjekur në një raft të vetëm, kur dëshironi që ushqimi të bëhet më shpejt dhe të jetë krokant.
	PJEKJE INTENSIVE Kjo metodë gatimi rezulton në një sipërfaqe krokante, pa yndyrë të shtuar. Ky është një version i shëndetshëm i skujjes së ushqimit të shpejtë, duke rezultuar në përbajtje më të ulët të kalorive. I përshtatshëm për copa më të vogla të mishit, peshkut, perimeve dhe produkteve të ngrira të gatshme për tiganisje (patate të skuura, copa pule).
	SKARË ME AJËR TË NXEHTË Ajri i nxehtë lejon qarkullim më të mirë të ajrit të nxehtë rreth ushqimit. Kjo do të thajë sipërfaqen. Në kombinim me ngrohësin apo pjekësin e skarës, kjo gjithashtu do të rezultojë në një ngjyrë më intensive. Për pjekje më të shpejtë të mishit dhe perimeve.
	PJEKJE TURBO Për gatimet që duhet të janë të thekura në të gjitha anët. Sistemi është gjithashtu i përshtatshëm si hapi i parë në modalitetin e pjekjes me hapa, pasi bën të mundur pjkjen e sipërfaqes në fazën e parë dhe pjkjen e ngadalëtë në fazën e dytë. Mish do të jetë i lëngshëm dhe me i thekur bukur nga jashtë.
	SKARA E MADHE Përdorni këtë sistem për të pjekur sasi të mëdha të ushqimit në formë të sheshtë si buka e thekur, sanduiçët e hapur, salische në skarë, peshk, hell etj., si dhe për të gatuuar au gratin dhe për të skuqur sipërfaqen. Ngrohësit e montuar në krye të zgavrës së furrës ngrohin në mënyrë të barabartë të gjithë sipërfaqen. Temperatura maksimale e lejuar: 240 ° C
	REZISTENCA E SIPËRME DHE E POSHTME Përdoren i këtë sistem për pjekje të zakonshme në një skarë të vetme, për të bërë sufle dhe për të pjekur në temperaturat të ulëta (pjekje me ngadalë).
	PJEKJE E BUTË Për gatim të ngadalëtë, të butë dhe të kontrolluar të ushqimit delikat (prerje të buta të mishit) dhe pjekje te ëmbëlsirave me një fund krokant.


Tabela vazhdon nga faqja e fundit

Simboli	Përdorimi	
	NGROHËSI I SIPËRM DHE I POSHTËM ME VENTILIM Për pjekjen e njëtrajtshme të ushqimit në një raft të vetëm, si dhe për të bërë sufle.	
	SKARË E MADHE ME VENTILIM Për pjekjen e pulave dhe racione më të mëdha të mishit nën skarë.	
	SKARA E MADHE DHE NGROHËSI I POSHTËM Për pjekje më të shpejtë në një raft të vetëm dhe për të pjekur sipërfaqen e ëmbëlsirave tuaja.	
	SKARË ME NGROHJE TË POSHTME DHE VENTILIM Për pjekjen optimale të brumit me maja, të gjitha llojet e bukës dhe për ruajtje.	
	PJEKJE INTENSIVE ME AVULL Shtimi i avullit gatuan më mirë sipërfaqen dhe krijon një kore krokante. Niveli më i lartë i lagështisë në pajisje ndihmon që sipërfaqja e pandispanjave dhe tortave të thahet më pak, të bëhet më e ngritur dhe e butë dhe të bëhet më e shndritshme. Avulli i shtuar do ta bëjë pjatën më pak të thatë. Ky funksion punon në një interval temperature mbi 150 °C.	
	NXEHËSI I SIPËRM DHE I POSHTËM ME VENTILATOR DHE AVULL 	SKARA E MADHE ME VENTILATOR DHE AVULL

Shtypni çelësin **start | stop** për të filluar procesin e gatimit. Në ekran shfaqen cilësimet e përzgjedhura.

FUNKSIONET E KOHËMATJES

Rrotulloni **ÇELËSIN** për të zgjedhur funksionet e kohëmatësit.



Simboli	Përkrimi	Përdorimi
	Koha e pjekjes	Në këtë modalitet, mund të përcaktoni kohëzgjatjen e funksionimit të furrës.
	Kohëmatësi	Kohëmatësi funksionon në mënyrë të pavarur nga funksionimi i furrës. Pas skadimit të kohës së caktuar, pajisja nuk ndizet dhe as nuk fiket automatikisht.
	Fund i vonuar	Përdoren këtë modalitet kur dëshironi që ushqimi në furre të fillojë të gatuhet me një vonesë në kohë. Vendosni kohëzgjatjen dhe kohën e dëshiruar të përfundimit të gatimit. Pajisja fillon automatikisht dhe mbaron funksionimin e saj në kohën e dëshiruar.



Vendosja e kohës së gatimit

Në këtë modalitet, mund të përcaktoni kohëzgjatjen e funksionimit të furrës (kohën e gatimit).

Ekrani shfaq për kohëzgjatjen e funksionimit. Rrotulloni ÇELËSIN për të vendosur kohën e dëshiruar të funksionimit. Konfirmoni cilësimin duke shtypur ÇELËSIN.

Shtypni çelësin **start | stop** për të filluar pjekjen.



Cilësimi i minutazhit

Minutazhi mund të përdoret në mënyrë të pavarur nga funksionimi i furrës. Vendosja më e gjatë e mundshme është 24 orë. Gjatë minutës së fundit, minutazhi shfaqet në sekonda.

Rrotulloni ÇELËSIN për të zgjedhur simbolin dhe konfirmoni cilësimin tuaj. Rrotulloni çelësin dhe caktioni kohëzgjatjen e minutazhit. Konfirmoni cilësimin duke shtypur ÇELËSIN.



Vendosja e përfundimit të vonuar



INFORMACION!

Fillimi i vonuar nuk është i mundur kur aktivizohet funksioni i ngrohjes paraprake.

Përdorni këtë funksion kur dëshironi të filloni të gatuani ushqimin në furre pas një periudhe të caktuar kohe. Vendoseni ushqimin në furre, pastaj caktioni sistemin dhe temperaturën. Pastaj, vendosni kohëzgjatjen e programit dhe kohën kur dëshironi që ushqimi juaj të bëhet.

Shembull:

Koha aktuale: 12:00 (mesditë)

Koha e gatimit: 2 orë

Fundi i gatimit: në orën 18:00

Simboli i kohëzgjatjes së gatimit do të shfaqet në ekran. Zgjidhni cilësimin dhe konfirmojeni atë duke shtypur KNOB (në rastin tonë, 2:00).

Shtypni përsëri KNOB dhe rrotullojeni për të zgjedhur simbolin .

Konfirmoni dhe caktioni kohën kur dëshironi që ushqimi juaj të përfundojë (në rastin tonë, është ora 18:00, ose 6 pasdite). Në ekran do të shfaqet koha e dëshiruar e përfundimit të gatimit (18:00). Konfirmoni cilësimin duke shtypur KNOB.

Shtypni çelësin **start | stop** për të filluar pjekjen.

Ndërsa prisni të aktivizohet, furra kalon në një gatishmëri të pjesshme (njësi e ekranit errësohet). Furra do të ndizet automatikisht me cilësimet e zgjedhura (në rastin tonë në 16:00 ose 4 pasdite). Furra do të fiket në kohën e caktuar (në rastin tonë, në 18:00 ose 6 pasdite).



INFORMACION!

Koha e mbarimit të gatimit dhe ora do të alternohen në njësinë e ekranit.

Pas skadimit të kohës së vendosur, furra ndalon së punuar automatikisht. Ekrani do të shfaqë **End**. Do të dëgjohet një sinjal akustik, të cilin mund ta fikni duke prekur cilindo tast. Pas një minute, sinjali akustik do të fiket automatikisht.



PARALAJMËRIM!

Ky funksion nuk është i përshtatshëm për ushqimin që kërkon paranxeheje të shpejtë paraprake.


Ushqimi që prishet nuk duhet të mbahet në furrë për një kohë të gjatë. Para se të përdorni këtë modalitet, kontrolloni nëse ora e pajisjes është vendosur saktë.

INFORMACION!

Funksioni i zgjedhur i kohëmatësit mund të rivendoset në 00:00 duke mbajtur shtypur ÇELËSIN.

PROGRAMI I HAPAVE

Ky modalitet lejon pjekjen në dy hapa ose faza (dy hapa rresht pjekjeje kombinohen në një proces të vetëm gatimi).



A1 hapi i parë i gatimit STEP1, (STEP2)

C kohëzgjatja e programit/fundi i programit (shih kapitullin Funksionet e kohëmatësit)

E temperaturë

Hapi: STEP1

Në modalitetin **pro bake**, caktoni sistemin e pjekjes dhe temperaturën. Gjithashtu, mund të zgjidhni funksionin e nxehjes së shpejtë paraprake. Më pas, caktoni kohëzgjatjen e pjekjes për STEP1 (shikoni kapitullin Funksionet e kohëmatësit). Konfirmoni cilësimin duke shtypur KNOB.

INFORMACION!

Në STEP1, mund të caktoni funksionin e fillimit të procesit më vonë; por, në këtë rast, nuk mund të aktivizoni paranxejen e shpejtë.

Hapi: STEP2

Shtypni dhe mbani shtypur modalitetin **pro bake**. STEP2 (hapi i dytë i gatimit) do të shfaqet në ekran (i pari tashmë është vendosur). Caktoni sistemin e pjekjes, temperaturën dhe kohëzgjatjen. Konfirmoni cilësimin duke shtypur KNOB.

INFORMACION!

Sistemet me injeksion me avull nuk mund të vendosen në STEP2.

Nëse dëshironi, mund të modifikoni STEP1 ose STEP2 para fillimit të tyre.

Shtypni çelësin modalitetin **pro bake** dhe zgjidhni STEP1. Tani mund të ndryshoni cilësimet. Pastaj, bënë të njëjtin veprim për STEP2.

Për të fshirë modalitetin e hapave, mbani shtypur modalitetin **pro bake**.


Shtypni çelësin **start | stop** për të filluar pjekjen. Furra fillimisht fillon të funksionojë me cilësimet e zgjedhura për STEP1. Kur përfundon STEP1, aktivizohet STEP2.

INJEKTIMI ME AVULL GJATË PJEKJES

Injektimi i avullit bën të ketë një skuqje më të mirë dhe një sipërfaqe më krokante.

Uji nga rezervuari pikon në mënyrë të kontrolluar në një tavë pranë ngrohësve të sipërm. Në këtë mënyrë, prodhohet sasia e duhur e avullit, duke bërë që të kemi në pjkje më të mirë dhe sipërfaqe më krokante, ndërsa thërrimet apo bërrhamat mbeten elastike dhe të shkrifta. Rekomandojmë përdorimin e injektimit me avull gjatë pjkjes së bukës, roleve të freskëta, roleve të pandispanjës, ëmbëlsirave, si dhe copave më të vogla të shpendëve dhe perimeve.


Injekzioni me avull gjatë gatimit mund të përdoret me sistemet në vijim: Përveç sistemit, ekran gjithashu shfaq STEAM +



1. Zgjedhja e funksionit

Vendosni enën e avullimit në anën e djathtë, nën pjesën e sipërme të zgavrës së furrës.

Shtypni tastin **pro bake** dhe vendosni:



A sistemi i gatimit

C kohëzgjatja e programit

E temperatura

- INFORMACION!

Ky funksion punon në një interval temperaturë mbi 150 °C.

Nxehja paraprake në sistemet me injekzion me avull nuk mund të vendoset. Efekti përkatës i avullit arrihet nëse funksioni ndizet ndërsa furra është ende e ftotë.

FILL

2. Ndejza e funksionit dhe mbushja e rezervuarit të ujit

Filloni të gatuani duke shtypur **start | stop**.

Ekrani do të shfaqë **Fill**. Mbushni rezervuarin e ujit (shih kapitullin "Mbushja e reyervuarit të ujit" më poshtë), pastaj shtypni **ÇELËSIN** për ta konfirmuar.


- INFORMACION!

Ndërsa ky funksion është aktiv, mund të dëgjoni tingullin e pompës, e cila është pjesë e funksionimit normal të pajisjes.

UnFil YES

3. Fikja e funksionit, përfundimi i procesit të gatimit dhe pastrimi i rezervuarit të ujit

Nëse ka mbetur ujë në rezervuar pas gatimit, ekrani do të shfaqë **UnFil** kur furra të ftohet, që do të thotë se duhet të zbrazni rezervuarin e ujit.



Hiqni ushqimin nga furra.

Për të kulluar menjëherë ujin nga rezervuari, hiqni enën e avullimit dhe futni një tepsí të thellë pjekeje pér të gjitha qëllimet në nivelin e 5-të. Rrotulloni ÇELËSIN dhe zgjidhni **YES**. Fillon procesi i zbrazjes së ujit nga rezervuari. Kur procesi të ketë përfunduar, hiqni tepsinë e pjeckes me ujë nga furra dhe thani furrën.

Nëse dëshironi të zbrazni rezervuarin e ujit më vonë, zgjidhni **No** (shih kapitullin "Zgjedhja e cilësimeve të përgjithshme").




-💡 **INFORMACION!**

Nësse, kur ekranit të shfaqë **UnFiL**, nuk zgjidhni **YES**, paralajmërimi do të shfaqet përsëri herën tjetër kur të përdorni furrën.

Mbushja e cisternës së ujit

Cisterna e ujit lejon furnizimin e pavarur me ujë në furren me avull. Kapaciteti i cisternës së ujit është afersisht 130 ml.

Mbusheni cisternën gjithmonë me ujë të pastër rubineti ose ujë në shishe pa aditivë. Uji i zbrazur në cisternën e ujit duhet të jetë në temperaturë dhome, d.m.th. afersisht 20 °C (+/- 10 °C).



1 Hiqni cisternën e ujit nga pozicioni duke shtypur çelësin. Kur shtypni çelësin, cisterna del jashët.

- INFORMACION!

Cisterna e ujit nuk mund të hiqet nga pajisja.

2 Hidhni ujë deri në shenjën **MAX** në rezervuarin e ujit (i mjaftueshëm për të gjithë procesin e gatimit).

3 Shtyni cisternën e ujit përsëri në pozicion deri ku të shkojë (do të dëgjoni kërcitje kur të zërë vend).

⚠ PARALAJMËRIM!

Nëse nuk respektoni shenjën **MAX** në depozitën e ujit dhe shtonи shumë ujë, uji i tepërt mund të rrjedhë përmes një të çare midis kapakut të depozitës së ujit dhe depozitës së ujit dhe mund të pikojë në dysheme.

Mos përdorni ujë të distiluar, ujë rubineti me përbajtje të lartë klori apo lëngje të tjera të ngjashme. Përdorni vetëm ujë të freskët rubineti, ujë të zbutur ose ujë mineral jo të gazuar.




MODALITETI AUTOMATIK (auto bake)

Në këtë mënyrë, ju mund të zgjidhni midis sistemeve të veçanta të pjekjes ose programeve automatike (programe të paracaktuara për lloje të veçanta të ushqimit).

Sistemet e veçanta të pjekjes

Prekni butonin **auto bake** dhe vendosni sa vijon:



B sistemet e veçanta të pjekjes

C kohëzgjatja e programit (shih kapitullin Funksionet e kohëmatësit)

E temperaturë

Rrotulloni ÇELESIN për të zgjedhur cilësimin tuaj. Do të shfaqen vlerat e paravendosura: ju mund të ndryshoni temperaturën dhe kohëzgjatjen e programit.

Simboli	Përdorimi
	PJEKJA E USHQIMIT TË NGRIRË¹⁾ Kjo metodë lejon pjekjen e ushqimit të ngrirë në një periudhë më të shkurtër kohe pa ngrohje paraprake. Optimale për produktet e ngrira të para-pjekura (produkte furre, briosh, lazanjë, patate të skuqura, copa pule), mish dhe perime.
	SISTEMI PIZZA Ky sistem është optimal për pjekjen e picave dhe pasticierive me përbajtje më të lartë të ujit. Përdoreni atë për të pjekur në një raft të vetëm, kur dëshironi që ushqimi të bëhet më shpejt dhe të jetë krokant.
	PJEKJE E NGADALTË²⁾ Për gatim të butë, të ngadaltë dhe të barabartë të mishit, peshkut dhe pasticierisë në një raft të vetëm. Kjo metodë gatimi do ta lërë mishin me një përbajtje më të lartë uji, duke e bërë atë më të lëngshëm dhe më të butë, ndërsa ëmbëlsira do të piqet në mënyrë të barabartë. Ky sistem përdoret në intervalin e temperaturave ndërmjet 140 ° C dhe 220 ° C
	AIR FRY ¹⁾ Kjo metodë gatimi rezulton në një sipërfaqe krokante pa yndyrë të shtuar. Ky është një version i shëndetshëm i skuqjes së ushqimit të shpejtë, me më pak kalori në ushqimin e gatuar. I përshtatshëm për prerjet më të vogla të mishit, peshkut, perimeve dhe produkteve të ngrira gati për tiganisje (patatet e skuqura, copat e pulës).

¹⁾ Në këto sisteme, është e mundur të përdoret funksioni gratin (shih kapitullin Fillimi i procesit të gatimit).

²⁾ Funksioni në fjalë përdoret për përcaktimin e klasës efikase energjike në përputhje me standardin EN 60350-1.

Paranxehja e shpejtë

Procedurat e gatimit për disa pjata në modalitetin e pjekjes automatike përfshijnë gjithashtu funksionin e paranxehjes së shpejtë. Shenja do të ndizet plotësisht. Kur të arrihet temperatura e zgjedhur, procesi i para -ngrohjes ndalet dhe lëshohet një sinjal akustik. **door** do të shfaqet në ekran. Hapeni derën dhe fusni ushqimin. Programi do të vazhdojë automatikisht pjekjen me cilësimet e zgjedhura.

- INFORMACION!


Kur caktohet funksioni i nxehjes paraprake, funksioni i fillimit më vonë nuk mund të përdoret.

Programet automatike

Në modalitetin automatik (auto bake), ju mund të zgjidhni midis programeve të shumta automatike (pajisa do të rekombinohen me metodën optimale të gatimit, temperaturën dhe kohëzgjatjen e gatimit në varësi të llojit të ushqimit të specifikuar).

Mbani shtypur butonin (auto bake) për të shfaqur programet automatike në ekran (shiko tabelën). Aty ku është e mundur, mund të caktioni edhe peshën e ushqimit.

Konfirmoni cilësimin tuaj duke shtypur KNOB. Shypni çelësin **start | stop** për të filluar pjekjen. Në ekran do të shfaqen vlerat e paracaktuara.



Një sistem pjekje

C Tregues automatik i programit/kohëzgjatja e programit

D Nxehje e shpejtë

E Sasia e zgjedhur

Treguesi	Emri i programit	Pajisjet	Niveli	Ngrohja paraprake	Kthimi
Pr01	amareta	tepsi e cekët	3	po	jo
Pr02	kekë të vegjël	tepsi e cekët	3	po	jo
Pr03	Kekë të butë	tepsi / pjatë në raft teli	2	po	jo
Pr04	ëmbëlsira të vogla me maja	tepsi e cekët	2	po	jo
Pr05	brumë sfoliat	tepsi e cekët	2	po	jo
Pr06	byrek me mollë	tepsi / pjatë në raft teli	2	jo	jo
Pr07	Strudel molle	tepsi e cekët	2	jo	jo
Pr08	Sufle me çokollatë	tepsi / pjatë në raft teli	3	po	jo
Pr09	ardhja dhe fryrja e brumit	tepsi e cekët	2	jo	jo
Pr10	bukë	tepsi e cekët	2	po	jo
Pr11	Rosto derri	enë e vogël pjekjeje në rrjetë teli	2	jo	jo
Pr12	Viç i pjekur	enë e vogël pjekjeje në rrjetë teli	2	jo	jo

Tabela vazhdon nga faqja e fundit

Treguesi	Emri i programmit	Pajisjet	Niveli	Ngrohja paraprake	Kthimi
Pr13	Pulë, e tërë	raft teli me tabaka kullimi	2	jo	pas 2/3 të kohës së gatimit
Pr14	Pulë - copa më të vogla	raft teli me tabaka kullimi	3	jo	pas 2/3 të kohës së gatimit
Pr15	rulet mishi	tepsi / pjatë në raft teli	2	jo	jo
Pr16	Biftek viçi i pjekur në furre	raft teli me tabaka kullimi	4	jo	pas 2/3 të kohës së gatimit
Pr17	Mish - gatim i ngadaltë	enë e vogël pjekjeje në rrjetë teli	2	po	jo
Pr18	Peshk i pjekur / i pjekur në skarë	raft teli me tabaka kullimi	4	jo	pas 2/3 të kohës së gatimit
Pr19	patate të pjekura, copa të prera patatesh	tava e pjekjes për të gjitha qëllimet	3	jo	jo
Pr20	Sufle perimesh	tepsi / pjatë në raft teli	2	jo	jo
Pr21	Iazanjë	tepsi / pjatë në raft teli	2	jo	jo
Pr22	pica	tepsi e cekët	1	po	jo


- INFORMACION!

Funksioni i gratinës mund të përdoret me disa programe automatike (shih kapitullin Fillimi i procesit të gatimit).



extra bake ZGJEDHJA E FUNKSIONEVE SHTESË (extra bake)

Prekni butonin **extra bake** për të shfaqur funksionet shtesë me vlerat e tyre përkatëse të paravendosura në njësinë e ekranit.



C kohëzgjatja e gatimit

D programi

E temperatura e paracaktuar

Rrotulloni ÇELËSIN për të zgjedhur programin. Do të shfaqen vlerat e paravendosura: Disa programe lejojnë vendosjen e temperaturës dhe kohën e gatimit.

INFORMACION!

Rrotulloni KNOB për të kaluar nga një program te tjetri. Konfirmoni çdo cilësim duke shtypur KNOB.



Piroлизë

Ky funksion lejon pastrimin automatik të brendësisë së furrës nga temperatura e lartë që djeg mbetjet e yndyrës dhe papastërtitë e tjera për t'i kthyer në hi.



Shkrirja

Përdoren këtë funksion për të shkrirë ngadalë ushqimin e ngrirë (ëmbëlsira, pasta, bukë, kulaçë dhe fruta shumë të ngrira).

Në mes të kohës së shkrirjes, copat duhet të kthehen na ana tjetër, të trazohen dhe të ndahan, nëse janë të ngrira së bashku.



Ringrohje

Kjo përdoret për të mbajtur ngrohtë ushqimin e gatuar tashmë. Ju mund të caktoni temperaturën dhe kohën e fillimit dhe mbarimit të rinxejjes.



Nxehja e pllakave

